

## MISIONI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Si banka qendrore e shtetit, Banka e Shqipërisë është autoriteti monetar i vendit dhe ka të drejtën ekskluzive:

- (i) të hartimit, miratimit dhe zbatimit të pavarur të politikës monetare. Objektiv i kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, që është kontributi më i mirë që mund të japë politika monetare për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë ekonomike të vendit;
- (ii) të nxjerrjes e të qarkullimit të monedhës shqiptare, duke siguruar ruajtjen e besimit publik të para, përmes garantimit të cilësisë së kartëmonedhave dhe monedhave dhe plotësimin të sigurt dhe eficient të nevojave të ekonomisë për para;
- (iii) të mbajtjes e të administrimit të rezervave valutoje të Republikës së Shqipërisë, si një garanci për përballimin e goditjeve të rënda në sektorin real të ekonomisë dhe në mbështetje të qëndrueshmërisë financiare të vendit.

Si emetuese e monedhës kombëtare, Banka e Shqipërisë nxit funksionimin normal të sistemit të pagesave me synim: sigurimin e qarkullimit të sigurt, të shpejtë dhe me kosto të ulët të parasë në ekonomi, parandalimin e rrezikut sistematik dhe ruajtjen e stabilitetit të institucioneve dhe tregjeve financiare.

Banka e Shqipërisë promovon stabilitetin e sistemit financiar – besimin publik tek institucionet, tregjet dhe infrastruktura financiare – duke rregulluar, licencuar dhe mbikëqyrur bankat dhe institucionet e tjera financiare, si dhe duke identifikuar dhe analizuar rregullisht rreziqet dhe kërcënimet ndaj stabilitetit financiar.

## VIZIONI I BANKËS SË SHQIPËRISË

Banka e Shqipërisë synon të forcojë mirëqeverisjen me qëllim rritjen e besimit të publikut tek institucioni. Kjo realizohet përmes:

- a) forcimit të pavarësisë në përmbushjen e misionit dhe objektivave ligjorë, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga procesi i përafrimit gradual të legjislativës dhe politikave tona me legjislativën e Bashkimit Evropian dhe Sistemit Evropian të Bankave Qendrore;
- b) rritjes së llogaridhënies përpara Kuvendit dhe publikut të gjerë për përmbushjen e detyrave kryesore, objektivit kryesor dhe objektivave të tjerë ligjorë të Bankës së Shqipërisë. Kjo përfshin edhe adoptimin e standardeve më të mira të kontabilitetit dhe auditimit, publikimin e raporteve të rregullta financiare, si dhe sigurimin e integritetit të proceseve të auditimit të jashtëm dhe të brendshëm si elemente kyçe të llogaridhënies publike;
- c) rritjes së transparencës mbi veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë përmes një komunikimi të hapur dhe të qartë me publikun. Banka e Shqipërisë do të marrë masat e duhura, në përputhje me ligjin dhe politikën e veta, për të rritur kuptueshmërinë dhe parashikueshmërinë e politikës monetare, për të përmirësuar llogaridhënien dhe për të forcuar besueshmërinë publike të institucionit.

